



**UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE-JURIDIKE**

ORGANIZON:

KONFERENCËN STUDENTORE

**"SFIDAT GLOBALE: PERSPEKTIVAT E SIGURTA
PËR TË RINJTË SI
KUSHT PËR REDUKTIMIN E MIGRACIONIT"**

DURRËS, 2023

THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCË

Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës organizon në 12 Prill 2023 Konferencën e Parë Studentore: "Sfidat globale: perspektivat e sigurta për të rinjtë si kusht për reduktimin e migracionit".

Kjo konferencë ka për qëllim të mbledhë së bashku studentë nga ciklet e studimit bachelor dhe master të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike dhe fakultete të tjera të Universitetit "Aleksandër Moisiu", si dhe studentë nga universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit për të prezantuar e diskutuar rreth gjetjeve e kërkimit të tyre mbi sfidat e sotme globale dhe migracionin.

Duke vlerësuar maksimalisht studentin për rolin e kontributin e tij të rëndësishëm në vijimësinë e debatit konstruktiv akademik, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike e konsideron këtë konferencë si një urë lidhëse të rëndësishme të komunikimit e përcjelljes interaktive të ideve, si dhe zhvillimit të perspektivave e këndvështrimeve të përbashkëta.

Konferenca do të zhvillohet e përqëndruar në boshtin e sfidave të sotme globale si dhe të fenomenit të migracionit ku studentët do të mund të analizojnë dhe diskutojnë mbi qasjet kombëtare, rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare të këtij fenomeni në dimensionin e zhvillimit të tyre personal dhe profesional.

Mirëpresim kontributet e studentëve mbi tematikat e mëposhtme, dhe jo vetëm:

- Migracioni i brendshëm dhe i jashtëm, 'zgjidhje' apo 'zgjedhje' e të rinjve
- Integrimi evropian vs. migracionit: sfida dhe problematika
- Zhvillimi i diasporës si tregues pozitiv i impaktit të migracionit në zhvillimin e të rinjve në Shqipëri
- Nëpunësi civil dhe rekrutimet në administratën publike, qasje legislative
- Legjislacioni ndërkombëtar dhe migracioni
- Legjislacioni shqiptar dhe ai evropian në raport me migracionin
- Krimet kibernetike dhe mbrojtja legislative
- Analizë e legjislacionit të brendshëm për migracionin
- Migracioni i rregullt në kuadër të parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore
- E drejta për azil në Shqipëri dhe politikat kundër migracionit të paligjshëm
- E Drejta Detare, drejt dimensioneve ligjore inovative
- Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve
- Reforma në drejtësi, dhe ndikimi i saj në të drejtën penale
- Zhvillimet moderne të së drejtës penale dhe sfidat aktuale të saj
- Të drejtat e punës dhe mbrojtja e tyre në gjykatën administrative
- Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje si dimension i menaxhimit të migracionit
- Edukimi i të rinjve
- Politikat lehtësuese qeveritare
- Politikat integruese
- Shkollimi profesional
- Ndikimi i mediave dhe teknologjive të komunikimit në migrimin dhe lëvizshmërinë e të rinjve

- Roli i medias në formësimin e opinionit publik për migracionin dhe perspektivat e të rinjve
- Portretizimi i të rinjve emigrantë në media
- Bashkëpunimi ndër-kufitar mediatik dhe shkëmbimi i informacionit mbi migracionin dhe perspektivat e të rinjve
- Roli i edukimit mediatik në adresimin e perspektivave të migracionit dhe rinisë
- Mediatizimi i politikave dhe masave të migracionit në media
- Ndikimi i medias dhe komunikimit në diskursin publik dhe politikëbërjen në lidhje me migracionin dhe perspektivat rinore
- Administrimi Publik dhe Qeverisja
- Politikat Publike
- Reforma në Administratën Publike
- Punësimi në Administratën Publike
- Roli i të rinjve në qeverisje
- Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe zhvillimi ekonomik
- Sfidat e Migracionit: Shqipëria përballë integritimit evropian
- Kriza ekonomike si faktor ndikues në dëshirën për migrim
- Politikat shtetërore, parameter në vendimmarrjen për migrim
- Në kërkim të modeleve politike e qeverisëse që ulin fenomenin e migracionit
- Politikëbërja, vendimmarrja dhe migracioni
- Sfidat globale: historia e sotmja dhe e ardhmja
- Sfidat globale për politikën identitare
- Qasje globale, sfida globale dhe mundësi globale

DATAT DHE AFATET:

| | |
|-------------------------------|-----------------------|
| Dorëzimi i abstrakteve | 3 Mars, 2023 |
| Njoftimi i pranimit | 10 Mars, 2023 |
| Data e Konferencës | 12 Prill, 2023 |

Vendi: Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, UAMD, Durrës, 12 Prill 2023

Gjuha e punimeve të konferencës: *shqip* dhe *anglisht*

Abstraktet deri në 800 fjalë duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme: fshpjstudentconference2023@gmail.com

Tarifa e konferencës: Pjesëmarrja në konferencë për studentët është pa tarifë.

UDHËZIME PËR PËRGATITJEN E ABSTRAKTIT:

Abstrakti duhet të punohet sipas rregullave teknike të mëposhtme:

- Abstrakti duhet të shkruhet në gjuhën shqip.
- Abstraktet duhet të punohen në Microsoft Word for Windows format, Times New Roman, font size 12, regular style, single spaced, alignment justified, margins all 2.5 cm.
- Abstraktet duhet të jenë maksimumi 800 fjalë.
- Abstrakti duhet të shprehë qartësisht qëllimin e kërkimit, qasjen e përdorur, dhe rezultatet kryesore.
- Titulli: Titulli i abstraktit duhet të jetë në madhësinë 12 point Times New Roman dhe bold.
- Emri i autorit: emri i plotë, institucioni dhe adresa e emailit.
- Trupi: Vetë abstrakti duhet të jetë 10-12 point, jo bold, single spaced Times New Roman, deri 800 fjalë i gjatë.
- Fjalët kyç: Të shkruhen në Times New Roman, 10 point, dhe shkrim i pjerrët.
- Burimet dhe referencat: sipas modelit APA ose Oxford System of Referencing.

Abstrakti duhet të dërgohet në adresën:

fshpjstudentconference2023@gmail.com

Për çdo pyetje lidhur me konferencën, mos hezitoni të na shkruani

në: Alternative e-mail: marsi_muca@yahoo.it

ose, Adresa: Universiteti 'A. Moisiu', Fakulteti Shkencave Politike-Juridike, **Kampusi** i Ri Universitar, Godina A, Spitallë, Durrës.